



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.37/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Jo Qeveritare (OJQ) “Krahët e Hapur”, me seli në Lipjan, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës (PDAK), dega në Lipjan, për shkak të vendosjes së posterëve në shtylla publike për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Organizatës Jo Qeveritare (OJQ) “Krahët e Hapur”, me seli në Lipjan, ndërsa subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës, dega në Lipjan, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 22.09.2017, nga Organizata Jo Qeveritare “Krahët e Hapur”, me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2017, kanë vërejtur se Bajram Gashi bartës i listës të PDAK në qytetin e Lipjanit ka vendosur posterat e tij në shtylla publike në qendër të Lipjanit, parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkëngjitur si dëshmi fotografitë e printuara nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës pretendon se Bajram Gashi bartës i listës së PDAK, Dega në Lipjan, ka thyer rregullat e fushatës.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkëngjitur fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës (PDAK), të datës 23.09.2017, nuk ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se posteri është vendosur nga vet parashtruesi i ankesës Bajram Ademi, drejtor i OJQ “Krahët e Hapur” i cili është edhe kandidat për asamble komunale nga radhët e Partisë së Ashkalinjëve për Integrim (PAI). Në vazhdim të përgjigjes potencon se foto me numër 1 është marr nga Facebook dhe nuk është shtypur nga ana e PDAK-së sepse kanë dizajn tjetër të posterëve, ku si dëshmi bashkëngjitur foton me numër 2 me të cilën theksohet se është posteri origjinal i PDAK-së, dhe se janë në dijeni që nuk lejohet ti vendosim posterat në vende publike. Pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur dy fotografi nga vendi ku janë larguar posterat.

PDAK kërkon nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre nga OJQ "Krahët e Hapur" të refuzohet sepse posterat e tyre janë të dizajnuara të njëjta në të gjithë Kosovën sipas vendimit të subjektit të tyre PDAK.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterat e bartësit të listës së PDAK-së, janë vendosur në shtyllë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: " *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*".

Paneli më rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që i kanë tërhequr posterat në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi me këtë gjob paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi,

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Zl.Anr. 37/2017 më datën 25.09.2017.



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.